



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA / MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e punës, Nr. 03/L-212, Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Nr.06/L-114 , Ligjin Nr. 08/L-196, për Pagat në Sektorin Publik dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit rishpall :

KONKURS

Titulli i punës: Inxhinier i Ndërtimtarisë

Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore- QRTK , Prishtinë

Kategoria funksionale: Krijues/e dhe performues/e i/e artit dhe kulturës - Profesional 2

Klasa e pozitës: K 7

Koeficienti : 7.5

Numri i referencës: RN00012363

Kodi: RPC0005931

I përgjigjet: Drejtorit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK), Prishtinë

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK), Prishtinë kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e projekteve për konsolidim, restaurim, konservim dhe mbikëqyrje;
2. Planifikon, koordinon dhe zbaton aktivitetet në fushën e trashëgimisë arkitektonike;
3. Harton programin e punës dhe ia dorëzon drejtorit të QRTK – Prishtinës;

4. Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të QRTK / DTK, koordinon aktivitete dhe bën përgatitjen e projekteve;
5. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
6. Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
7. Bën hulumtime, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve të specializuara të miratuara;
8. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
9. Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
10. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
11. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
12. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë

1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë:

1.1 të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;

1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;

1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplomë/ a të studimeve universitare (Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës –Drejtimi Ndërtimtari Konstruktive, me të paktën 240 kredi/ ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e Diplomës Bachelor dhe Master);
2. Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale , në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;
3. Përparësi është përvoja në kuadër të institucioneve publike dhe në fushën e strukturave ndërtimore tradicionale, si dhe përvojë pune në fushën e trashëgimisë kulturore;

4. Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
5. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
6. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
7. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
8. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
9. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Ligjin e punës, Nr. 03/L-212, Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyratë Publiqe të Republikës së Kosovës, Nr.06/L-114 , Ligjin Nr. 08/L-196, për Pagat në Sektorin Publik dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Procedura e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është pa afat të caktuar.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 21.08.2023 deri me dt.19.09.2023, ndërsa data e aplikimit është nga data 20.09.2023 deri me datën 04.10.2023.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Web faqen e MKRS-se.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit , ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme. Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).